

4 - Si dallohet diabeti gestacional

Të gjitha gratë që shfaqin të paktën një faktor risku për diabetin gestacional (shiko skedën n°4 "Diabeti gestacional") duhet të kryejnë provën e ngarkesës orale me 75 g glukozë. Vetëm me anë të provës së ngarkesës orale me glukozë është e mundur të konstatojmë ose përjashtojmë praninë e diabetit gestacional.

Kur duhet kryer prova e ngarkesës



Midis javës së 16^o dhe 18^o të shtatzënisë nëse gratë janë obeze, nëse kanë pasur diabet gestacional në një shtatzëni të mëparshme apo nëse kishin, para ose në fillim të shtatzënisë, vlera të glicemisë esëll midis 100 dhe 125 mg/dl.



Nëse prova e kryer midis javës së 16^o dhe 18^o të shtatzënisë rezulton normale, përsëriteni provën e ngarkesës midis javës 24^o dhe 28^o.



Midis javës 24^o dhe 28^o nëse gratë janë mbi 35 vjeç, janë mbipeshë, kanë një histori familjare të diabetit, kanë pasur makrozomi (zhvillim i madh i trupit) fetale të mëparshme apo diabet gestacional të mëparshëm ose vijnë nga vende të origjinës me mbizotërim të theksuar të diabetit.

Tre fazat e testit

Prova e ngarkesës orale me glukozë është një test që nuk ka efekte negative mbi fetusin, kryhet në tre faza.



Fillimisht matet glicemia e nënës esëll.



Më pas i jepet nënës një gotë ujë në të cilën janë tretur 75 g glukozë.



Pas 1 ore dhe pas 2 orësh merren dy mostra gjaku për të përcaktuar nivelin e sheqerit në të.



Për të kryer testin duhet të jeni esëll prej të paktën 8 orësh, të qëndroni ulur dhe të mos pini duhan gjatë gjithë kohëzgjatjes së testit.



Në ditët përpara testit nuk duhet të ndryshoni zakonet tuaja të ngrënies apo të eliminoni ose të reduktoni konsumin e ëmbëlsirave, bukës, makaronave, sheqerit etj.